



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESORE PRIVATE



ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE
KOZETA CAKA

Nr. 373/6 Prot
Nr. 373 Dosje

Tirane, me 15 / 02 / 2019

URDHER
PER VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendres Kombetare te Biznesit, Tirane
Per dijeni: Debitorit Shoqeria "Seament Albania" sh.p.k.
Adresa: Kalata Lindore, Porti Durres

Une, Kozeta Caka, Permbaruese Gjyqesore Private me Licence Nr. 39, date 10.09.2010, ne referim te Urdherit te Ekzekutimit Nr. 8684 Regj. Themeltar, date 05.11.2018, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, leshuar per Titujt Ekzekutive, Faturat Tatimore Nr. 389, date 14.07.2017 dhe Nr. 274, date 26.07.2016,

KONSTATOJ

Se ne zyren e Permbarueses Gjyqesore Private Kozeta Caka, eshte depozituar me date 30.01.2019, kerkesa e pales kreditore Shoqeria "Ecit" sh.p.k., perfaqesuar nga administratori Ergest Mileti, per ekzekutimin e Urdherit te Ekzekutimit Nr. 8684 Regj. Themeltar, date 05.11.2018, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, leshuar per Titujt Ekzekutive, Faturat Tatimore Nr. 389, date 14.07.2017 dhe Nr. 274, date 26.07.2016, per ceshtjen me pale:

Kreditor: Shoqeria "Ecit" sh.p.k.
Debitor: Shoqeria "Seament Albania" sh.p.k.
Objekt: Permbushje detyrimi

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka leshuar Urdhrin e Ekzekutimit me Nr. 8684 Regj. Themeltar, date 05.11.2018, per Titujt Ekzekutive, Faturat Tatimore me Nr. serie 48008664, Nr. 389, date 14.07.2017, ne vleren 33.600 leke, dhe Nr. serie 38543515, Nr. 274, date 26.07.2016, ne vleren 28.800 leke.

Pas kalimit te afateve te parashikuara ne nenin 517 te K.Pr.Civile, per ekzekutimin vullnetar, ne kushtet kur detyrimi nuk eshte ekzekutuar, ka filluar ekzekutimi i detyrueshem i titullit ekzekutiv.

Ne keto kushte, ne referim te nenit 527 te K.Pr.Civile duhet te vendoset sekuestro konservative, duke vene sekuestro mbi kuotat e pales debitore Shoqeria "Seament Albania" sh.p.k., me NIPT J61827093K, regjistruar prane QKR-se me date 23.04.1994, me seli Kalata Lindore, Porti Durres, Durres, me administrator Mark Bouri, dhe moskryerjen e asnje veprimi qe mund te tjetersoje asetet e shoqerise, per ekzekutimin e vendimit te sipercituar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile si dhe nenit 46 te ligjit nr. 10031 date 11.12.2008 "Per sherbimin permbarimor gjyqesor privat".

URDHEROJ:

1. Vendosjen e Sekuestros Konservative mbi kuotat e **pales debitore Shoqeria "Seament Albania" sh.p.k., me NIPT J61827093K, regjistruar prane QKR-se me date 23.04.1994, me seli Kalata Lindore, Porti Durrës, Durrës, me administrator Mark Bouri,** dhe moskryerjen e asnje veprimi qe mund te tjetersoje asetet e shoqerise, deri ne nje urdher te dyte nga Zyra Permbarimore Kozeta Caka.
2. Per informimin, bllokimin dhe veprimet qe duhet te kryeni pas marrjes se njoftimit te ketij urdhri ne lidhje me debitoret e siperpermendur te njoftohem ne rruge zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat qe behen pengese, apo te cilet i paraprijne ndonje ndryshimi te mundshem te pronesise se mjeteve te luajtshme ne emer te debitoreve te permendur ne piken 1, brenda afatit te pergjigjes zyrtare, qe nga dita e njoftimit te ketij urdhri, do te pergjigjen sipas dispozitave sanksionuese qe parashikon Kodi i Procedures Civile dhe Kodi Penal i Republikes se Shqiperise, ne lidhje me pengimin e ekzekutimit te vendimeve gjyqesore apo te titujve ekzekutive.
4. Ky urdher mbahet ne 3 (tre) kopje, dhe u njoftohet paleve te cilat kane te drejten e ankimit ne gjykate brenda 5 diteve, nga dita e marrjes dijani.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE " KOZETA CAKA"

Permbaruese GJYQESORE

Kozeta CAKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANE



Nr. 8684 Regj. Themeltar
Data e regjistrimit 18.10.2018.

Date 05.11.2018

VENDIM
(PËR LËSHIMIN E URDHËRIT TË EKZEKUTIMIT)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga:

Gjyqtare :Dhurata BALLA

Me cilësinë e gjyqtarit të vetëm në dhomë këshillimi sot më date 05.11.2018, mora në shqyrtim çështjen civile që i përket

KERKUES: Shoqëria "ECIT" Sh.p.k., person juridik regjistruar me numër NUIS L02904408M, me seli ne adresen Rruga Autostrada Vore-Durres, km.5, Marikaj, perfaqesohet nga Avokate Gentiana Qendro, ndermjet autorizim perfaqesimi date 05.06.2018, anetare e Dhomes se Avokatise Tirane, me Nipt L71531020U, licence 7179 dhe me adrese :Njesia Administrative nr.2, Rruga Labinoti, Pallati nr.6, Apartamenti nr.5, Tirane.

OBJEKTI: Lëshim I Urdhrit të Ekzekutimit për Faturat Tatimore të Shitjes me TVSH me këto të dhëna: 1) Faturë Nr Serial 48008664, Nr Fature 389, Datë 14.07.2017, Vlera 33,600.00 Lekë. 2) Faturë Nr Serial 38543515, Nr Fature 274, Datë 26.07.2016, Vlera 28,800.00 Lekë.

Detyrimin e palës debitore Shoqëria "SEAMENT ALBANIA" shpk të paguajë kamat vonesat ligjore për detyrimin e rrjedhur nga mos pagesa e faturave të mësipërme të llogaritura sipas legjislacionit tatimorë në fuqi.

Baza Ligjore: Nenet 510,511 e vijues te K.Pr.Civile(i azhornuar), Nenet 5, 16 të Ligjit Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare", Ligji nr.114/2016"Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr.8116, date 29.03.1996

Gjykata, pasi mori në shqyrtim pa praninë e pales kerkuese kërkesen objekt gjykimi, duke iu referuar përmbajtjes së saj dhe provave shkresore bashkangjitur,

VËREN:

Se kërkuesi **Shoqëria "ECIT" Sh.p.k** i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesë për "Lëshim I Urdhrit të Ekzekutimit për Faturat Tatimore të Shitjes me TVSH me këto të dhëna: 1) Faturë Nr Serial 48008664, Nr Fature 389, Datë 14.07.2017, Vlera 33,600.00 Lekë. 2) Faturë Nr Serial 38543515, Nr Fature 274, Datë 26.07.2016, Vlera 28,800.00 Lekë. Detyrimin e palës debitore Shoqëria "SEAMENT ALBANIA" shpk të paguajë kamat vonesat ligjore për detyrimin e rrjedhur nga mos pagesa e faturave të mësipërme të llogaritura sipas legjislacionit tatimorë në fuqi", me Shites: **Shoqëria "ECIT" Sh.p.k** dhe Bleres: **Shoqëria 'Seament Albania' shpk.**

Nga studimi I akteve rezultoi se subjekti **Shoqëria "ECIT" Sh.p.k**, ka per objekt te aktivitetit te tij tregtare kryerjen e kontrollit teknik te pajisjeve ne presion etj, sipas ketij objekti I ka ofruar sherbime **Shoqerise 'Seament Albania' shpk** duke leshuar edhe faturat tatimore perkatese. Fakt që vërtetohet me Faturat Tatimore të shitjes: 1) Faturë Nr Serial 48008664, Nr Fature 389, Datë 14.07.2017, Vlera 33,600.00 Lekë. 2) Faturë Nr Serial 38543515, Nr Fature 274, Datë 26.07.2016, Vlera 28,800.00 Lekë". Rezulton se faturat objekt gjykimi jane te pashlyera.

Nisur nga sa u parashtrua më lart, çështja që do të merret në shqyrtim në rastin konkret nga ana e gjykatës është :I. Nëse ekzistojnë apo jo kushtet për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes për **Shoqërine "ECIT" Sh.p.k**, në kuptim kjo të nenit 16 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet Kontraktore Tregtare, neni 16, përcaktohet shprehimisht se:

"1. Detyrimet monetare, te lindura nga veprimet juridike tregtare, te cilat nuk jane shlyer brenda afatit te pageses perkatëse, sipas ketij ligji, me perjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 I Kodit Civil, perbejne titull ekzekutiv dhe vihen ne ekzekutim nga përmbartuesi gjyqësorë, pavarsisht vlerës, kur:

a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontrates dhe ligjit;

b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin."

Në nenin 510 gërma "e" të K.Pr.Civile parashikohet shprehimisht se konsiderohen tituj ekzekutivë të gjitha aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet Zyra e Përmbartimit për ekzekutimin e tyre.

Po kështu, në referim të përcaktimeve të nenit 511, paragrafi i fundit, pika "d" të Kodit të Procedurës Civile (ndryshuar nëpërmjet Ligjit Nr. 114/2016), detyrimi i titullit ekzekutiv si më sipër, shoqërohet edhe me kamatë vonesat ligjore të kësaj shume, nga data e lëshimit të urdhërit të ekzekutimit, deri në momentin e përmbushjes së detyrimit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare". Këto kamata, do të përlogariten pranë shërbimit përmbartimor në momentin e ekzekutimit të titullit të mësipërm ekzekutiv.

Në këto kushte gjykata çmon se duhet të lëshojë urdhrin e ekzekutimit për faturën tatimore, në mënyrë që të bëhet e mundur që nëpërmjet procesit përmbartimor të bëhet përmbushja e detyrimit nga debitori, në format që parashikon ligji për titujt ekzekutiv, siç janë faturat tatimore të cituara më lart.

Lidhur me sa mësipër gjykata çmon se kërkesa e kërkuarit **Shoqëria "ECIT" Sh.p.k.**, duhet pranuar si e bazuar në ligj dhe në prova dhe për pasojë duhet lëshuar urdhëri i ekzekutimit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata bazuar në nenin 510(e) dhe 511(d) të Kodit të Procedurës Civile dhe neni 5,16 i ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet Kontraktore Tregtare",

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit **Shoqëria "ECIT" Sh.p.k.**
- Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes:
 - 1) Faturë Nr.Serial 48008664, Nr.Fature 389, Datë 14.07.2017, me vlerë 33,600.00 Lekë.

2) Faturë Nr.Serial 38543515, Nr.Fature 274, Datë 26.07.2016, me vlere 28,800.00 Lekë, me shites: **Shoqëria "ECIT" Sh.p.k** dhe bleres: **Shoqëria "ECIT" Sh.p.k** dhe mbi këtë detyrim të përlogariten nga përmbarusi gjyqësor në fazën e ekzekutimit, kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht sipas Nenit 5 te Ligjit Nr.48/2014 «Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare».

- Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje.
 - Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese.
- U shpall sot në Tiranë, më date 05.11.2018.**

**GJYQTARE
DHURATA BALLA**

SHPENZIMET GJYQSORE
Tarife regjistrimi 200 lekë

